

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “ HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



**PUNIM DIPLOME**  
**(master)**

**Tema:**

**Dallimet ndërmjet karateistëve dhe jo karateistëve të rinjë në disa aftësi  
bazike motorike**

**Mentori:**

**Prof. Dr. Ajvaz Berisha**

**Kandidati:**

**Fidan Rexhepi**

**Prishtinë 2020**

## **PËRMBAJTJA**

<b>1. HYRJE.....</b>	<b>4</b>
1.1 HISTORIKU I KARATESË.....	5
1.2 ZHVILLIMI I STILIT SHOTO-KAN.....	6
1.3 ZHVILLIMI I KARATESË NE KOSOVË.....	7
1.4 HULUMTIMET E DERITANISHME.....	8
<b>2. QËLLIMI I HULUMTIMIT.....</b>	<b>10</b>
<b>2.1. HIPOTEZAT THEMELORE.....</b>	<b>11</b>
2.2. NDIKIMI I AFTËSIVE LËVIZORE NË KARATE.....	12
2.2.1. Forca.....	13
2.2.2. Shpejtësia.....	15
2.2.3. Kordinimi.....	16
2.2.4. Fleksibilitete .....	17
2.2.5. Qëndrueshmeria.....	18
2.3. RELACIONET NDËRMJET AFTËSIVE BIOMOTORE.....	19
2.4. METODAT E HULUMTIMIT.....	21
2.4.2. Mostra e të hulumtuarve (nxënësit).....	22
2.4.3. Mostra e ndryshoreve.....	22
2.4.4. Ndryshorët lëvizore.....	23
2.5 KUSHTET DHE ORGANIZIMI I MATJEVE.....	24
2.6 PËRSHKRIMI I TESTEVE LËVIZORE.....	25

<b>3.</b>	<b>METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE.....</b>	<b>34</b>
<b>4.</b>	<b>REZULTATET DHE DISKUTIMI.....</b>	<b>35</b>
	4.1 TREGUESIT THEMELORË STATISTIKORË.....	35
	4.2 NDËRLIDHJET E NDRYSHOREVE MOTORIKE MANIFESTE.....	36
	4.3 T-TESTI PËR NDRYSHORET MOTORIKE TË KARATEISTËVE DHE NXËNËSVE.....	41
	4.4 ANALIZA DISKRIMINUESE KANONIKE NË HAPËSIRËN MANIFESTE ANTROPO METRIKE DHE MOTORIKE.....	43
	4.5 STRUKTURA FAKTORIALE E HAPËSIRËS LËVIZORE.....	46
	4.6 KARAKTERISTIKAT LATENTE MORFOLOGJIKE.....	49
<b>5.</b>	<b>VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....</b>	<b>51</b>
<b>6.</b>	<b>PËRFUNDIMI.....</b>	<b>52</b>
<b>7.</b>	<b>LITERATURA.....</b>	<b>54</b>

## 1.HYRJE

Karateja bënë pjesë në grupin e sporteve luftarake dhe ka për qëllim kalitjen e sportistit dhe gjithë popullatës që e ushtron këtë sport për vetëmbrojtje.

Sot , në botën shqiptare , sporti dita e ditës vjen duke u lartësuar dhe duke thithur rininë në gjirin e tij, e veçmas sporti i karatesë.

Gjatë ushtrimit të sportit të karatesë zhvillohet I tërë organizimi me perjashtime të vogla të sistemeve të caktuara, si sistemi muskolor I pjesëve të sipërme të trupit.

Karateja nuk është vetëm sport, por është edhe art, filozofi etj. Është filozofi në kuptimin e plotë të fjalës për arsye se tek njerëzit parimet e karatesë që I jep mësuesi I karatesë moderne "Gichin Funakoshi" janë thënie filozofike.

Po i përmendim vetëm dy nga këto parime: "Karate sente nashi" (në karate nuk sulmohet I pari) dhe "Gijitsu yori shinjutsu" (arti I mendjes është më i rëndësishëm se arti I teknikës).

Karateja është quajtur edhe sport I intelegjencës, për arsye se pjesa më e madhe njerëzve që merren me karate janë me shkollim superior. Karateja si sport nuk bënë vetëm kalitjen fizike , por edhe përgatitjen psikike, intelektuale,njëkohësishtë ndihmon në zhvillimin e koncentrimit.

Demonstrimi i lëvizjeve në karate është mjaft interesant dhe shumë më I komplikuar se sa që I sheh shikuesi I thjeshtë, për shkak se në të njejtën kohë duhet të ekzekutohen shumë komponente si p.sh. forca, shpejtësia, ritmi, frymëmarrja, siguria, qëndrimi, koncentrimi, kontrolli si dhe funksionet tjera.

Duke pasur parasysh se forca konsiderohet më e rëndësishmja për shumicën e sporteve, të sportev luftarake, aftësia e shpejtësisë është specifike e veçantë, sepse kjo është përcaktues i suksesit dhe radhitet e para në hierarkinë e aftësive motorike.

Veçori tjetër që ndikon tek karateistet në suksesin e tyre është aftësia kordinimit (agjilitetit) dhe fleksibilitetit. Këto aftësi luajnë rol shumë të rëndësishëm në ekzekutimin e detyrave të ndërlikuara motorike.

Jam i mendimit se punimin që e kam marrë në konsultim me mentorin tim të nderuar Ajvaz Berisha , kemi marrë qëndrime dhe kemi ardhur në përfundim se një punim i këtillë do të ofrojë të dhëna statistikore dhe teorike që do të rezultojnë me një bazë të mire shkencore.

## 1.1 HISTORIKU I KARATESË

Karateja, që sot e njohim është zhvilluar për disa shekujë nën ndikimin kinez në Okinavë. Në çerekun e parë të shekullit të 19-të, ky art luftarak për të parën herë rregullisht u praktikua në Japoni. Pra fillimi i tij nuk është në Okinavë. Përmes shkëmbimeve kulturore me Kinën, vinin edhe shpresat e larta kineze në Okinavë, të cilat këtu sollën edhe stilet të ndryshme të Kung-Fu-së (në japonisht: KEMPO), kjo ndodhte në mënyrë fragmentare dhe pa sistem.

Faktet historike, sa i përket zhvillimit deri te arti luftarak "karate" fillojnë me SAKUGAËA në Okinavë, i cili prej vitit 1733-1815 jetonte dhe mbante ligjëratat për artin luftarak To-de, mjeshtri të cilën ai e kishte mësuar në Kinë. "To" do të thotë dorë, duar (art luftarak me duar).

Këto stilet luftarake "Te-Do" ( më vonë "Kara-Te") ose edhe vetëm shkurtimisht të quajtur "Te" zhvilloheshin në qytetet fqinjë Shuri, Naha dhe Tomari (2). Sipas zonës në të cilën është zhvilluar artin luftarak këto emërtoheshin edhe si "Naha-Te", "Shuri-Te" edhe Tomari-Te (1,2).

Ka fundi i shekullit XIX u ndërruan emrat e stiveve të ndryshme luftarake , stilet e rrethinës së Shurit dhe Tomarit emërtoheshin si Shorin-Riu, ndërsa në Naha format e mësimit cilësoheshin si "Shorei-Riu (3).

Në shekullin e mesëm Japonia zhvillohej nën ndikimin e Kinës, prandaj në mes të tjerave ata e përvetësuan edhe shkathtësinë e luftës Chuan-Fa të cilën e emërtuan Kara-Te, që në përkthim nga japonishtja d.m.th. "DORA E ZBRAZËT"-pa armë. Themelet e karatesë moderne janë të lidhura me krijuesin e saj Gichin Funakoshi (1868-1957) dhe ishulin Okinava. Në atë periudhë karateja zhvillohej në disa drejtime, kështu që si pasojë vjen deri tek krijimi i disa stiveve, në mesin e të cilëve më të njohurit janë: Goju Ryu, Shito Ryu, Shot Kan dhe Ēado Ryu. Ne do të ndalemi shkurtimisht në zhvillimin e stilit Shoto Kan.

## 1.2.ZHVILLIMI I STILIT SHOTO-KAN

Nga viti 1922 deri pas luftës së dytë botërore, në Japoni vërtetë tashmë kishte pak shkolla të karatesë në (Ryu), por jo shoqata si institucione të organizuara në kuptimin administrativ. Ekzistonte vërtetë “Nihon Karate-Do Shotokaj” si shoqatë e nxënësve të Funakoshit, por kjo nuk ishte si Federatë në kuptimin e sotëm.

Shoqëria Japoneze e Karatesë (JKA) është themeluar në vitin 1955 nga Masatoshi Nakayamai i cili ishte ligjëruesi kryesor. Kjo ishte shoqëria e parë e karatesë në Japoni. Shoqëritë e tjera të stilëve të ndryshme vijuan më vonë. Këto më vonë në vitin 1964 në kuadër të Olimpiadës të Tokios me orientimin me influencëtë famshmit dhe të nderuarit mjeshtër të karatesë Gogen Yamaguchi (Goyo-Ryu) iu bashkangjitën FAJK-së (Federata e organizatave Karate-Do të Japonisë).

Nën drejtimin elastic të kësaj federate lindi një federate botërore (ËUKO d.m.th. Federata e të gjithave organizatave Karate-Do të botës, të cilës më vonë iu bashkangjitën të gjitha llojet e stilëve. Shoqëria Japoneze e karatesë(JKA) së shpejti themelojë një shoqëri të vetme që kishte të bëjë më tepër me mënyrën e stilit Shoto Kan, pra një shoqëri botërore “Federatën Ndërkombëtare të Karatesë Amatore” (JAFK), megjithatë shoqëria japoneze e karatesë (JKA) është shoqata më e madhe dhe sipas mendimit të mësuesit Nakayama për pjesën dërrmuese të karateistëve të stilit Shoto- Kan është vendimtare në botë.

Shoto-Kan Internacional (SKI) është formuar në mes të viteve të shtatëdhjeta të shekullit XX nga mjeshtri i famshëm karatesë botërore (JKA) Hirokaso Kanazava, të cilit së shpejti i pasojnë themelime shoqatash në nivel kombëtar. Kanazava nga shumë njerëz nderohet me “Mister Shoto-Kan” dhe kërkon që konceptin e tij të Shoto-Kanit ta përhapë në gjithë botën.

### 1.3. ZHVILLIMI I KARATESË NË KOSOVË

Karateja në Kosovë paraqitet në vitet e 70-ta të shekullit XX. Për here të parë në Kosovë e ka kultivuar njëri ndër mjeshtrit më të mëdhenjë të ish Jugosllavisë Dr. Ilija Jorga. Ai pas emërimit si profesor pranë Universitetit të Prishtinës, hapi klubin e parë të karatesë në vitin 1970 dhe e pagëzojë me emrin "UNIVERSITETI", klub i cili në gjirin e vet grumbulloi rininë studentore të asaj kohe.

Më vonë klubi pushojë aktivitetin e vet, por me ndihmën e disa të rinjëve student si: Isak Latifi, Nagip Murati, Nazmi Ibërdemaj, Ali Latifi, Shemsedin Murati, Shemsedin Kelmendi, Ekrem Taraku etj. Ky sport përhapet anë e mbanë Kosovës. Vlen të përmendet se të gjitha klubet në Kosovë ushtruar stilin "Shotokan", ndërsa në Ferizaj është ushtruar stili i karatesë "Jucokaj" i cili fillojë punën në vitin 1978 nën drejtimin e profesor Fahri Mahallës.

Më vonë në vitin 1987 në Kosovë fillon të ushtrohet edhe stili "Shito-Ryu". Mirëpo si stili më i përhapur dhe me dominant në Kosovë mbetet stili Shotokan.

Në atë kohë d.m.th. në vitet 1990 e deri në përfundim të luftës në Kosovë kemi një ngecje të karatesë në të gjitha aspektet por prapë se prapë edhe në atë kohë janë mbajtur gara të ndryshme nëpër qytetet të ndryshme të Kosovës.

Një pjesë e trajnerëve u angazhuan në radhët e UÇK-së si eprorë të lartë për përgatitjen e ushtarëve dhe njësive special të UÇK-së e në mesin e tyre ishte edhe profesori Ajvaz Berisha.

Pas luftës karateja në Kosovë eci shumë shpejtë dhe brenda këtyre viteve kemi shumë kampionë të turneve të ndryshme ballkanike, evropiane e botërore.

Ka shumë karateistë të mire që kanë vepruar, por më të suksesshmit në përgjithësi nga shqipëtarët janë: Enver Idrizi (kampion botëror) Afrim Latifi (kampion i Evropës) etj.

## 1.4. HULUMTIMET E DERITANISHME

Disa hulumtime nga kjo degë sportive janë bërë te ne dhe te të huajt, në këtë rast do të përmend vetëm disa, ku është trajtuar problematika e aftësive motorike.

Shumica e punimeve të këtyre autorëve ka të bëjnë me përcaktimin e strukturës së hapësirës motorike si dhe relacioneve në mes dimensioneve të kësaj hapësire.

Prej autorëve të cilët janë marrë me hulumtime në popullatën e sportistëve (karateistëve) janë:

**B. Kuleš dhe J. Marić** në mostrën e 25 karateistëve kualitativ të trajtuar në 6 variabla prediktore të tipit të shpejtësisë së levizjeve me duar dhe këmbë dhe 4 variabla kritere të vlerësimit të suksesit në karate, kanë vërtetuar rolin dominant të këtyre levizjeve në suksesin në karate.

Autorët **S. Čupina** dhe **B. Mikić** në mostrën e 73 karateistëve me metoden e analizës regresive kanë vërtetuar vlerën e lartë të prediksonit të aftësive lëvizore motorike në realizimin e strukturave komplekse në teknikat e karatesë.

**Dr. B. Kuleshi (1985)** në mostrën e 55 karateistëve garues në kategorinë absolute të karatesë klasike ka vërtetuar lidhmëri të lartë ndërmjet 13 variabla antropometrike dhe suksesit të tyre në karate e vlerësuar me nivelin e gjykimit të tre vlerësuesve kompetent. Rezultatet janë përpunuar me analizën klasike regresive.

Hulumtimi i ndikimit të dimensioneve morfologjike në suksesin e karatesë e me këtë edhe në arritjen e rezultateve sportive është njëra nga detyrat primare. Vetëm analiza sipërfaqësore somatike e karateistëve nëpër kategori, na drejton në përfundimin se personat më të gjatë dhe më të zhvilluar me një sasi të vogël të indit dhjamor nënlekuror janë më të suksesshëm në karate. Levat e gjata sigurojnë arritje të caktuar në gjatësi dhe njëkohësisht një largësi të caktuar nga kundërshtari e më këtë edhe një mundësi më të sigurt të mbrojtjes nga sulmet e tij. Rëndësia e levave të gjata është edhe e madhe kur dihet se goditjet që përdoren në karate janë, direkt (tzuki dhe maegeri), të cilët ekzekutohen nga një distancë maksimale. Muskulatura e karateistit është pak e theksuar, është muskulaturë elastike e cila mundëson lëvizjet e shpejta dhe eksplozive me një amplitudë të madhe.

Sasia e madhe e indit dhjamor për karateistët është pengesë, sepse ngadalëson lëvizjen dhe nuk janë karakteristikë e tyre. Eshtrat e forta po ashtu janë karakteristikë e tyre, prandaj mund të paramendohet se ka lidhmëri në nëpërmjet kualitetit dhe disa dimensioneve transversal të skeletit.

Në punim shihet se diametri i gjurit diç më pak masa e trupit dhe diametri i krahut ndikojnë negativisht në suksesin e luftës sportive, kjo sigurisht ndoshta për shkak të shpejtësisë e cila në karatenë klasike është aftësi dominante. Është e theksuar se te karateistët kulmorë si dimensione të theksuara morfologjike është euriformia një theksim i dimensionit longitudinal, vëllim trupor dhe dimensionit transversal i skeletit.

**Dr. B. Kuleshi (1985)** në mostrën e 55 karateistëve të cilët kanë bërë gara në kampionatin e Kroacisë, hulumton lidhmërinë antropometrike me suksesin në luftën klasike të karatesë në kategorinë absolute. Ndryshorja "suksesi në luftën sportive" është formuar në bazë të rezultateve të karateistëve, të arritura në disa sezona të garave. Kur se karakteristikat e tyre morfologjike janë vërtetuar përmes 13 ndryshoreve antropometrike me suksesin në luftërat e karatesë (P-82), lartësia e trupit dhe



perimetri i kafazit të krahërorit, janë prediktorët më të mirë për këtë sukses, normalisht në hapësirën manifeste. Në hapësirën antropometrike latente, ekzistojnë dy dimensione latente: eurimorfia dhe indi dhjamor nënlekuror. Lidhmëria e tyre me ndryshorët kritere "suksesi në luftë sportive" është po ashtu e lartë ( $P = .72$ ), për këtë lidhmëri praktikisht është përgjegjës vetëm dimensionimi I pare.

**Dr. B. Kullushi (1985)** në mostrën e 86 të ekzaminuarve studentët e FKFK në Zagreb të moshës 20-23 vjeçare, ka hulumtuar ndikimin e agresivitetit bazik në suksesin e luftës sportive të karatesë me kontakt relativ plotë. Hipoteza e vendosur mbi ndikimin pozitiv të agresivitetit në suksesin e karatesë me kontakt të plotë, është testuar nëpërmjet analizës regressive. Interpretimi i lidhjeve të fituara është bërë në hapësirën latente të agresivitetit bazik nga i cili janë izoluar 25 faktorë.

Është paraqitur korelacioni i lartë multitip i faktorëve të agresivitetit bazik dhe suksesit në luftën sportive të karatesë me kontakt të plotë 75, koeficienti i determinimit 56 që vërteton parashikimin e ndikimit të rëndësishëm të agresivitetit bazik në suksesin e luftës sportive të karatesë me kontakt të plotë. Koeficienti më të lartë pozitiv në suksesin e luftës sportive në karate, kanë pasur ata faktorë të agresivitetit, të cilët janë formuar si pasojë e karakteristikave funksionale të qendrës së rregullimit gjatë reaksionit të sulmit të ashtuquajtura si ndikues endogjen. Kurse ndikimi i atyre në prapavijën e të cilave gjendet qendra e disfunkcionimit të reaksioneve mbrojtëse, të cilat janë formuar nën ndikimin e faktorëve ekzogjen në suksesin e luftës sportive në karate është më e vogël dhe pa vlerë.

#### **Autorët vendorë:**

**A. Berisha (2002)** në hulumtimin e tij të magjistraturës ka përfshi 100 të egzaminuar, prej të cilëve 50 kanë qenë sportistë aktiv në karate dhe atë të të gjitha brezave me dominim të brezit të zi, 50 të egzaminuar të grupit kontroll domethënë grup jo sportive. Personat e përfshirë në studim ju takojnë moshave të ndryshme (21-25 vjeç) dhe të dy gjinive.

**A. Berisha (2005).** Struktura dhe relacionet e disa ndryshoreve motorike, parametrave morfologjik dhe funksional fiziologjik të karateistëve dhe xhudistëve. Në hulumtimin janë përfshirë 104 të egzaminuar të karateistëve dhe xhudistëve të moshës 14-15 vjeç duke ju përshtatur rrethanave, kushteve dhe kërkesave të kohës për të kontribuar në rritjen e cilësisë së sportit të karatesë dhe xhudos. Qëllimi parësor i këtij hulumtimi është shqyrtimi i dallimeve ndërmjet karateistëve dhe xhudistëve në disa variabla antropometrike, motorike dhe funksionale fiziologjike.

**V. AMETI (2004),** Vlerësimi i disa aftësive motorike bazike dhe situacionale tipike për sportin e mundjes stili i lirë. Mostra për hulumtim ka përfshirë 15 nxënës të moshës 14-15 vjeç të testuar nga 16 teste të hapësirës motorike. Ka vërtetuar ndikimin e variablave motorike predikte në prognozimin e rezultateve të variablave kritere, dhe vërtetimi i lidhshmërive ndërmjet variablave motorike dhe ka fituar tre faktorë.

**Sh. SHALA (2008).** Relacioni i faktorit longitudinal me tri aftësi motorike të karateistëve të Kosovës. Në hulumtimin numri i mostrës së entitetit është 44 të gjinisë mashkullore dhe 5 të gjinisë femërore ku janë përfshirë karateistë aktiv. Në mostrën e ndryshoreve përfshihen 5 ndryshore antropometrike dhe 13 ndryshore motorike. Janë parashtruar tri hipoteza prej të cilave njëra është vërtetuar plotësisht ndërsa dy të tjera pjesërisht.

## 2.QËLLIMI I HULUMTIMIT

Duke pasur parasyshë numrin e vogël të hulumtimeve të këtij lloji nga sporti i karatesë te ne janë munduar që të jap një kontributë në këtë lëmi, andaj si qëllim parësor i këtij hulumtimi është:

- Vlerësimi i disa aftësive motorike të grupit të karateistëve dhe jokarateistëve , si dhe dallimet ndërmjet tyre;

Qëllime tjera janë:

- Vërtetimi i ndërlidhjeve të aftësive lëvizore,si te karateistët ashtu edhe te të rinjët të cilët nuk merren me karate në mënyre sistematike;
- Vërtetimi i dallimeve ndërmjet dy grupeve të trajtuara në hapsiren manifeste dhe në atë latente për aftësitë lëvizore të trajtuara;
- Vërtetimi i strukturës faktoriale të aftësive lëvizore të trajtuara

## 2.1 HIPOTEZAT THEMELORE

H1-priten që të ekstratohen tre faktorë në hapsirën motorike

H2-priten që të vërtetohen lidhmeritë statistikisht të vlefshme të variablave që masin shpejtësinë, koordinimin dhe fleksibilitetin.

H3-pritet të kemi dallime të rëndësishme statistikore në aftësitë motorike ndërmjet dy grupeve të trajtuara

## 2.2 NDIKIMII AFTËSIVE LËVIZORE NË KARATE

Është vështirë të definohej pasi që varen prej sistemit nervor. Zaciorski thotë: “ aftësitë lëvizore thjesht mund të quhen anë kualitative lëvizore”.

Konsiderohet se aftësitë lëvizore janë karakteristika komplekse, të cilat manifestohen me lëvizje në masat e ndryshme varësishtë prej llojit të lëvizjes, të potencialit individual të tyre.

## 2.2.1.Forca

Forca është aftësia e muskujve që ti kundërvihet apo t'a mposhtë rezistencën e jashtme. Në periudhën nga mosha 12-14 vjeç është e rekomandueshme që nën mbikqyrje të fillohet me demonstrimin e ushtrimeve të forcës me sforcim deri në 77% të masës trupore . Rënia intensive hetohet pas moshës 45 vjeqare. Sforcimi mund të jetë dinamik dhe statik.

Forca dinamike mund të manifestohet si repetitive(përsëritese) dhe statike.

Elementare për karatenë është rritja e fuqisë maksimale të muskujve të orientuar në rritjen e shpejtesise se levizjeve.Zhvillimi I forces ne kuader te rritjes se shpejtesise aplikohet me intensitetin e ngarkeses prej 60-80% nga maksimumi.

Metodat me te shpeshta per zhvillimin e forces ne karate jane:

**-Metoda e ngarkeses submaksimale dhe maksimale**

**-Metoda per refuzim**

**-Metoda e perseritjes me shpejtesi maksimale**

Forca me te cilen zhvillohet teknika e kartese eshte njera nder elementet kryesore e cila karakterizon bazen teknike ne kata.Forca (impulsi I forces sasia e levizjeve) me te cilen zhvillohet nje teknike e karatese eshte prodhim I pjeses se mases se trupit (I cili merr pjese ne zhvillimin e teknikes) I percjellur ne piken e kontaktit ne fillim (trupin e kundesharit) dhe shpejtesise me te cilen vëhet kontakti me rastin e ndeshjes.Meqe forca me te cilen zhvillohet nje teknike eshte drejt proporcionale me masen e muskujve te cilet marrin pjese ne levizjet e dhena,ky eshte fillim themelore me rastin e komponimit te teknikes se karatese qe ne zhvillimin e teknikes te inkuadrohen masat e medha te muskujve.

Me zhvillimin e me shume teknikave te dores p.sh. marrin pjese muskujt e kembeve,masa me e madhe dhe e forte e muskujve te njeriut,te cilat gjenden rreth brezit dhe ijeve,pastaj krahrorit,kraheve dhe ne fund duarve.Renditja e sakte me te cilat keta muskuj kontaktojne, forca dhe shpejtesia e kontraktimit te tyre orientojne forcen kah vendi I kontaktit,perafersisht qellimit dhe percaktojne formulimin e levizjes. Qe te arrihet kjo jane te domosdoshme ushtrime te shumta dhe çka eshte me e rendesishme,ushtrimet ne menyre perkatese.

Me rastin e zhvillimit te rregullt te karatese forca ne pjese te ekstremiteteve te cilat vëjne ne kontakt me qellim eshte jashtzakonisht e madhe. Qe kjo te jete drejt e percjellur ne qellim ,te gjithë muskujt te cilet kane zhvilluar teknike(levizje) duhen te jene te kontraktuar me renditje te caktuar dhe force te caktuar , kurse bazamenti dhe boshti neper te cilat forca percillet duhet te jene ne pozite te rregullt.

Kjo gjithashtu kerkon ushtrime dhe trajningje te orientuara dhe te zhvilluara mire qe teknika te zhvillohet si duhet (qe te jete racionale dhe efikase) perafersisht jane me rendesi elementet per te cilat do te behet fjale:

Mbajtja e trupit dhe rrotacioni I ijeve jane me rendesi te posaçme per efikasitetin e teknikes se karatese, levizjen e rregullt dhe pergjimin e lendimeve (perafersisht tek teknika e cila zhvillohet me dore).

Rendesia themelore te zhvillimi I teknikes se karatese eshte qe trupi te mbetet ne rrafsh te njejte me ijet. Tek shumica e teknikave te karatese trupi eshte I drejte nen vije te drejte krahasuar me dysHEME. Kjo pozite e trupit eshte me rendesi per shume arsye tjera.

Forca e cila zhvillohet me kontraktimin e mases se madhe te muskujve rreth brezit dhe ijeve ( I cili kontraksion eshte me rendesi te veçante me rastin e zhvillimit te teknikes se dores) percillet me dore e cila zhvillon teknike per gjate shtylles se kurrizit. Levizja e saj qofte per boshtin e gjate (mbeshtjellje perpara dhe prapa apo anash) qofte per boshtin e gjere (rrethiminkur forca nuk eshte ne rrafshin e njejte me ijet), bie tek shkapenderdhja e forces, perpos kesaj edhe veshtirson forcimin e shtylle se kurrizit dhe trupit.

## 2.2.2 Shpejtësia

Shpejtësia është aftësi e njeriut që të zhvillojë lëvizje për një kohë sa më të shkurtër në kushtet ekzistuese. Shpejtësia nuk ndryshon esencialisht nën ndikimin e ushtrimeve. Kjo është kështu nga shkak se edhe muskujt e shpejtë si dhe ata të ngadalshëm ashtu edhe raportet e ndërsjella kryesisht janë të përcaktuar me trashëgimi gjenetike. Shpejtësia zhvillohet nga mosha 7-17 vjeç ndërsa shpejtësia më e madhe arrihet deri në moshën 20-22 vjeçare. Rënja intensive e shpejtësisë fillon pas moshës 30 vjeçare. Shpejtësia përbëhet nga: **Shpejtësia e reaksionet, shpejtësia e një lëvizjeje, frekuenca e lëvizjes.**

Mënyrat e zhvillimit të shpejtësisë në karate: **Mënyra sensoriale, mënyra përsëritjes, mënyra e thyerjes së barriers së shpejtësisë, mënyra analitike.**

Shpejtësia me të cilën zhvillohet teknika e karatesë paraqet një ndër faktorët themelorë prej të cilës varet efikasiteti i aksionit (pra çka është njëra ndër elementet themelore për vlerësimin e teknikës së goditjeve me duar në karate) është me rëndësi edhe për pak shkak të lidhshmërisë

### 2.2.3. Koordinimi

Koordinimi është aftësi për të ekzekutuar lëvizje të shpejta në shkallë të ndryshme të vështirësisë me efikasitet dhe saktësi. Konsiderohet se karateisti me koordinim të mirë është i aftë jo vetëm për ta ekzekutuar mirë shkathtësinë, por edhe të zgjedhë shpejtë detyrat stërvitore.

Sipas L.P.Matfejevit detyra kryesore të cilën duhet të realizojë gjatë rregullimit të koordinimit është miratimi i formave të ndryshme të lëvizjes. Kjo sjell deri te pasurimi i motorikës dhe ndikon pozitivisht në mundësin e analizimit motorik. Është e nevojshme që në mes të ekzekutimit të ushtrimeve të planifikohet intervale pushues për përmirsimin e tërësishëm në mënyrë që të vijë deri te sistemi nervor, përkatësishtë ngatërrimit të sinkronizimin të shumë qendrave rregulluese dhe pjesve lokomotive periferike të aparatit.

Është vërtetuar se ekzistojnë më shumë faktor koordinues, si shpejtësia dhe koordinimi ritmik, koordinimi i mësimit të detyrave motorike, orientimi hapsinoro-kohor, agjiliteti gjithashtu shpejtësia e ndërrimit të kahjes së lëvizjes dhe statike, përkatësishtë barazpesha dinamike.



## 2.2.4. Fleksibiliteti

Fleksibiliteti është aftësi e ekzekutimit të veprimeve të lidhura në amplitude të gjerë të lëvizjes. Amplituda natyrale e lëvizjes rreth secilit artikulation në trup varet nga koordinimi i tendineve, ligamenteve, indeve ndërlidhëse dhe muskujve. Limiti i amplitudës së lëvizjes të artikulationit quhet “fundi i pozicionit”. Lëndimet mund të ndodhin kur gjymtyra ose muskuli sforcohet përtej limitit të tij.

Trajningu i fleksibilitetit mund të ndihmojë në zvogëlimin e rrezikut të lëndimeve, me ngritjen graduale të amplitudës së lëvizjes së artikulacioneve.

Fleksibiliteti i kufizuar është një ndër shkaktarët më të rëndomtë të ekzekutimit të dobët të teknikës dhe rendimentit. Fleksibiliteti i dobët gjithashtu vështirëson shpejtësinë dhe qëndrueshmërinë pasi që muskujtë duhet të punojnë më shumë për të mbuluar efektshëm rezistencën e gjatësisë së hapit të madh.

Fleksibiliteti i tendinëve zvogëlohet kur ne jemi të moshuar, përderisa femrat zakonisht kanë më shumë fleksibilitet gjatë gjithë moshës së tyre. Është më rëndësi që karteistët e rinjë, të fillojnë me programet e rregullta të zgjatjes (streçingut) për të parandaluar humbjen e fleksibilitetit e cila vjen nga mosha.

## 2.2.5. Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria është aftësi e organizmit për të i'u kundërvënë lodhjes. Lodhja varet nga intensiteti, kohëzgjatja dhe lloji i punës. Ekzistojnë lloje të ndryshme të qëndrueshmërisë, nga të cilat më të rëndësishme janë e **përgjithshmja** dhe **specialja**. Qëndrueshmëria e përgjithshme duhet zhvilluar në periudhën prej moshës 12-15 vjeç ndërsa për zhvillimin e qëndrueshmërisë speciale më rëndësi është periudha prej moshës 18 vjeç. Funkzioni i qëndrueshmërisë fillon të bije në mënyrë intensive pas moshës 40 vjeçare.


**Qëndrueshmëria e përgjithshme (aerobe)** nënkupton aftësinë afatgjate të sforcimit të muskujve me intensitet të matur. Qëndrueshmëria e përgjithshme më së shpeshti zhvillohet në mënyrën e përsëritjes, mënyrën e ndërrimeve dhe atë kontinuitive. Të gjitha mënyrat i karakterizon puna në masë të madhe, por me intensitet të matur.

**Qëndrueshmëria speciale (anaerobe)** është aftësi e kryerjes së punës intensive e cila është e kushtëzuar me aftësinë anaerobe të organizmit. Në këtë rast nevoja për oksigjen është më e madhe nga ajo mund të sigurohet. Suksesin ndemonstrimin e kates ose luftës në masë të madhe varet nga aftësia e përsëritjes në kohën e caktuar. Zakonisht për zhvillimin e qëndrueshmërisë speciale përdoren të gjitha teknikat e karatesë përmes mënyrave të përsëritjes dhe atyre të garimit. Në këtë mënyrë do të mbizotrohej lodhja dhe do të mundësohej punë efikase e teknikës. Qëndrueshmëria speciale duhet të bazohet në qëndrueshmërinë e përgjithshme deri në 50%, qëndrueshmëria ndaj shpejtësisë deri në 30% dhe në shpejtësinë deri në 20%.

### 2.3 RELACIONET NDËRMJET AFTËSIVE BIOMOTORE

Aftësitë biomotore janë ndaras për të identifikuar karakteristikat e secilës. Në praktikë nuk ka gjëra të tilla si ushtrime të forcës “të dobëta” apo ushtrime shpejtësie “të dobëta”. Aftësitë biomotore janë komponentë e formës fizike të përgjithshme dhe të kuptuarit e raporteve reciproke i mundëson trajnerit të planifikojë trajning më të efektshëm.

Autorë të ndryshëm si Fidov (1933) dhe Hotz (1996) lëvizjen si një dukuri komplekse e krijuar nga një sërë faktorësh si: motivi, kondicioni, njohja, dhe koordinimi.



Skema sipas Fidov dhe HO

### 2.3.1 PERIUDHAT E NDJESHME PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE LËVIZORE

SPORTI	MOSHA
Koordinimi	5 - 8
Shpejtësia dhe reagimi	8 - 10
Forca eksplozive	10 - 12
Shpejtësia maksimale	10 - 14
Forca maksimale	12 - 14
Qëndrueshmëria në forcë	12 - 14
Qëndrueshmeria anaerobe	14 - 16

Skema 2

## **METODAT E HULUMTIMIT**

Mostra e të hulumtuarve përfshin 50 karateistë të gjinisë mashkullore dhe 50 nxënës jo karateistë të gjinisë mashkullore, të moshës 14 – 15 vjeçare.

Te gjithë karateistët janë të seleksionuar pasi që janë garues të cilët marrin pjesë në gara dhe kanë rezultate, atëherë është e natyrshme se të gjithë do të jenë të aftë në aspektin psikofizik që ti nënshtrohen testimit të tillë, po ashtu edhe nxënësit jo karateistë do të jenë në gjendje të mire psikofizike që ti nënshtrohen testimit.

Mostra e të testuarve është marrë nga karateistë të ndryshëm të klubeve të ndryshme të Kosovës si në Drenas dhe Prishtinë.

## **MOSTRA E TË HULUMTUARVE (Nxënësit)**

Mostra e entitetëve (nxënës) është 50 dhe është marrë nga nxënësit e moshës 14 – 15 vjeçare të shkollës fillore "Arif Shala" në Korroticë të poshtme komuna Drenasit. Kriteri themelor për testimin e nxënësve ka qenë:

- a) që rregullishtë te jenë prezentë në orën e edukatës fizike
- b) që paraprakisht nuk janë të sëmurë.

## 2.4.3 MOSTRA E NDRYSHORËVE

### 2.4.4 Ndryshorët lëvizorë

#### Shpejtësia

- |                    |        |
|--------------------|--------|
| 1. Vrapim 30 m     | MVR30M |
| 2. Taping me këmbë | MTAPKM |
| 3. Taping me dorë  | MTAPDO |

#### Koordinimi

- |                         |        |
|-------------------------|--------|
| 1. Tetëshja me përkulje | MTETPR |
| 2. Hapa anash           | MHAPAN |
| 3. Katërkandëshi        | MKATKD |

#### Fleksibiliteti

- |                                     |        |
|-------------------------------------|--------|
| 1. Fleksibiliteti në bankë          | MKATKD |
| 2. Fleksibiliteti me këmbë anash    | MFLKAN |
| 3. Fleksibiliteti – spakata ballore | MSPABA |

## 2.5 KUSHTET DHE ORGANIZIMI I MATJEVE

Matja e aftësive lëvizore të nxënësve është bërë në sallën e edukatës fizike të shkollës fillore "Arif Shala", Korroticë të poshtme poligoni sportivë i kësaj shkolle, ndërsa matjet e karateistëve janë bërë nëpër sallat e atyreve klubeve ku kanë stërvitur dhe në poligone jashtë sallave.

Në zhvillimin e matjen dhe vlerësimin e testeve janë përdorë këto instrumente:

Metri shirit metalik për matjet që janë bërë, kronometri për matjen veprimtarive, kona dhe rekuizita ndihmëse për improvizimin e vendëve për zhvillimin e testeve.



## 2.6.PËRSHKRIMI I TESTËVE LËVIZORE

### VRAPIM 30 METRA – Starti i lartë



Fig. 1

Me këtë testë masim shpejtësinë e përshpejtimit.

**Mjetet:** kronometri, pipi sinjalizues, gjipsi për shenimin e vijes së startit dhe cakut dhe flamujt për shënimin e startit dhe cakut.

**Detyra:** subjekti qëndron me të dy këmbet pas vijes së startit, në pozicion të startit, në pozicion të startit të lartë. Startuesi jep komandën “gati” (pas se cilës subjekti përkulet para, me peshën në këmben e përparme) dhe dëgjohet “sinjali” pas së cilës subjekti fillon vrapimin dhe tentohet që maksimalisht shpejt të vrapohet distanca prej 20cm. Në momentin kur startuesi jep komandën për nisje aktivizohet kronometri në mënyre elektronike dhe pasi garuesi kaloje sensorin laserik koha ndalet dhe lexohet. Ekzekutohen dy prova, ndërsa shenohet rezultati më i mirë.

**Vlerësimi:** matet koha prej startit deri te caku dhe rezultati i fituar shënohet ne fletëtestin përkates me saktësi 0.01 sek.

## TAPINGU ME DORË




Fig. 2

**Mjetet:** banka, karriga, dy pllaka nga letra e trashë me diameter 20 cm. Shiriti ngjitës të dukshme dhe kronometri.

**Udhëzimi:** rrathët ngjiten me ngjitës në bankë në largësi 61 cm nga njëri-tjetri (skajet e brendëshme), dhe gjatë testimit duhet të jenë dy matës, ku njeri mbanë kronometrin, ndërsa numëron ekzekutimin e ushtrimit.

**Detyra:** subjekti i qëndron i ulur në karrikën dhe vendos dorën me të dobët në bankë në mes të dy rrathëve, ndërsa dorën tjetër e vendos mbi pllakë. Subjekti duhet sa më shpejtë ta takojë njerën, pastaj pllakën tjetër në kohë prej 15 sec nga momenti i dhënies se komandës “tash”.

**Rezultati:** shënohen të gjitha prekjet e rregullta të cilat matësi i numëron brenda 15 sec. Llogaritet çdo takim i dy pllakave (një cikël).

## TAMPINGU ME KËMBË – MTK



Fig. 3

**Mjetet:** kronometri, dysheku gjimnastikor.

**Detyra:** goditet me të dy këmbet në mënyrë alternative mbi shenjën e vendosur në dyshekun e gjimnastikes i cili është i vendosur afër murit vertikalisht, në lartësinë nga toka 356 cm, dhe të kufizuar në një katror 20 X 20 cm. I testuari për një kohë prej 15 sec duhet ta godas sa më shpejtë që mundet me pjesën e përparme të këmbëve në mënyrë të pandërprerë, dy herë me njëren e dy herë me këmben tjetër.

Numrohet çdo e dyta goditje, testi përsëritet dhe shënohet rezultati më i mirë.

## HAPA ANASH – MHA



Fig. 4

**Mjetet:** kronometri, shiriti ngjitës me ngjyrë të dallueshme.

**Udhëzim:** dy copa të ngjitësit me gjatësi 0.5 m vendosën në dysheme në largësi 4 m paralel njëra me tjetrën.

**Detyra:** subjekti qëndron afër vijës së nisjes me këmbë të bashkuara, i kthyer terthorazi me vijën. Në shenjë “tash” nisët me shpejtësi më të madhe të mundshme dhe lëviz me hapa – anash, duke mos i kryqëzuar këmbët, deri te vija tjetër dhe kthehet në anën tjetër duke mos e ndërruar poziten e trupit. Subjekti duhet që largësinë prej 4 m ta kalojë 6 herë.

Kronometri ndalët kur subjekti me njëren këmbë arrinë te vija e nisjes .

Rezultati shënohet me saktësi prej 0.1 sec.

## TETËSHJA ME PËRKULJE – MTP



Fig. 5

**Mjetet:** kronometri, dy shtylla dhe një litar 5 m i gjatë.

**Udhëzim:** shtyllat vendosen largë njëra tjetrës në largësi prej 4 m dhe ne të lidhet litarit me lartësi të pikës më të lartë të ashtit të legenit (lartësia e litarit rregullohet me secilin subjekt veqmas).

